



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

N. 274/2 Prot.

Tiranë, më 26 gusht 2021

Rregullore e procedurave të pranimit për program të dytë studimi në Universitetin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Viti Akademik 2021-2022

Informacion i përgjithshëm

Procedurat e pranimit në një program të dytë studimi në UKZKM miratohen në përputhje me Urdhrin nr.12, të datës 26/08/2021, të publikuar në faqen zyrtare: www.unizkm.al.

Për t'u pranuar në një Program të dytë Studimi në Universitetin Katolik ZKM kandidatët duhet:

- të jenë të pajisur me një diplomë të lëshuar nga një universitet i akredituar;
- të kenë përfunduar studimet universitare në programe të të njëjtit cikël me atë për të cilin po bëhet kërkesa, p.sh. Program studimi Bachelor → Program studimi Bachelor (Infermieri/Fizioterapi); Program i integruar studimi → Program i integruar studimi (Farmaci/Mjekësi).

Kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e sipërpërmendura do të konsiderohen "Kandidatë të pakualifikuar për t'u regjistruar në një program të dytë studimi" dhe do të kenë ende mundësinë e regjistrimit në vitin e parë të studimeve sipas procedurave të parashikuara në Udhëzimin nr.10, datë 15.05.2019.

Kandidatët e huaj që nuk e kanë përfunduar arsimin e mesëm në Itali ose në një shkollë të mesme ku gjuha zyrtare e mësimin nuk është gjuha italiane, duhet të kenë Certifikatën e mbrojtjes së gjuhës italiane të paktën në nivelin B1, siç parashikohet në Udhëzimin Nr. 52 datë 03/12/2015, ose të kryejnë testimin mbi njohjen e Gjuhës Italiane të organizuar nga Universiteti Katolik ZKM në momentin e regjistrimit.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen njëkohësisht në disa programe studimi në të njëjtin vit akademik, në universitete publike dhe/ose private, shqiptare dhe/ose të huaja.

Kreu I-Procedurat e pranimit në një program të dytë studimi për kandidatët shqiptarë

1. Si të aplikoni për program të dytë studimi

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.6, datë 25/06/2021 të QSHA dhe RASH, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për regjistrim në një program të dytë studimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të Universitetit Katolik ZKM **nga data 2 Shtator deri në datën 13 Shtator 2021.**

Për të aplikuar për program të dytë studimi në Universitetin Katolik ZKM, kandidatët **duke nisur nga data 2 Shtator 2021** duhet:

- Të regjistrohen *online* në Portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>
 - Të përzgjedhin zërin: "Secondo corso di laurea"
 - Të plotësojnë procedurën duke ngarkuar online kopje elektronike në format PDF (të skanuara në format pdf/A) dokumentacionin e mëposhtëm për regjistrimin në një program të dytë studimi.
- a. Formulari i aplikimit për program të dytë studimi drejtuar IAL (shkarkohet në portalin: <http://admissions.unizkm.al/#/>)
- b. Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve të mëparshme universitare, të shoqëruar me suplementin e diplomës;



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- c. Vërtetim të studimeve të kryera, të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet (vetëm për kandidatët që kërkojnë njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);
- d. Diplomën e Maturës Shtetërore dhe listën e notave;
- e. Kartë identiteti ose pasaportë.

Shënim: Nëse dokumentacioni i mësipërm nuk është në gjuhën italiane, duhet të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet përpara se të ngarkohet në Portalin e Universitetit.

Pas ngarkimit të dokumentacionit të mësipërm, do të kryhen verifikimet përkatëse për çdo kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>.

2. Procedurat e pranimit

2.1- Për programet e studimit në Infermieristikë, Fizioterapi, Mjekësi dhe Kirurgji, Odontoiatri dhe Proteza Dentare:

Kandidatët që konsiderohen të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në Portalin <http://admissions.unizkm.al/>, duhet të kryejnë testimin e pranimit pranë Universitetit Katolik për kuotat e parashikuara për pranim në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë, në datat e mëposhtme:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	24/09/2021	11:00
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	24/09/2021	14:00
Program i studimit në <i>Fizioterapi</i>	24/09/2021	16:00
Program i studimit në <i>Infermieristikë</i>	24/09/2021	16:00

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara në testimet e mëposhtme dhe nga vlerësimi i mesatares së përgjithshme të shkollës së mesme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali	80 pikë

Një komision i veçantë didaktik do të vlerësojë karrierën universitare të kandidatëve të shpallur fitues të testimit të pranimit. Komisioni Didaktik bën njohjen/njehsimin e plotë apo të pjesshëm të krediteve ECTS/të provimeve të shlyera dhe përcakton vitin specifik ku do të regjistrohet kandidati, në qoftë se programi i studimit i përfunduar më parë është i të njëjtës fushë ose të një fushe të përafërt me programin e studimit ku ai aplikon. Në rast të kundërt, procedohet me regjistrimin e kandidatit në vit të Parë (I).



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Brenda datës 21 Shtator 2021, ora 16:30, kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi dhe do të marrin pjesë në testime, duhet të paguajnë pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit (e disponueshme nga e hëna në të premte ora 8:00 –16:30 dhe të shtunave ora 8:00 -13:00) tarifën prej 2000 lekë për pjesëmarrjen në testimin e pranimit.

Po ashtu, pagesa mund të kryhet me kartë krediti në Portalin e Universitetit : admissions.unizkm.al.

-Për programet e studimit në Farmaci dhe Ekonomi Ndërmarrjeje

Dokumentacioni i kandidatëve që aplikojnë për program të dytë studimi do t'i paraqitet Komisionit Didaktik ad hoc të secilit program për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara për çdo kandidat nga mesatarja e përgjithshme së shkollës së mesme dhe nga studimet universitare të kryera më parë:

1.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	50 pikë
2.	Studimet universitare të kryera më parë (kredite të njohura)	50 pikë
	Totali	100 pikë

3. Listat e renditjes

Listat e renditjes së aplikantëve do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM <https://www.unizkm.al/>. Kandidatët mund të përjashtohen nga lista e renditjes nëse gjenden parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për aplikim.

4. Procesi i regjistrimit

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.6, datë 25/06/2021 të QSHA dhe RASH, kandidatët e shpallur fitues duhet të kryejnë regjistrimin përfundimtar në datat **7 deri më 11 Tetor 2021**, duke dorëzuar pranë Sekretarive Mësimore përkatëse dokumentacionin e mëposhtëm:

- 4.1 Kopje të noterizuar të diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës (të pajisur me vulën Apostile të vendit të origjinës nëse kandidati është diplomuar jashtë vendit);
- 4.2 Dokumenti i njehsimit ¹të Diplomës universitare së studimeve universitare të kryera më parë lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë origjinal ose në kopje të noterizuar (vetëm për kandidatët që janë diplomuar jashtë vendit). Për ata që nuk janë pajisur me dokumentin e Njehsimit nga kjo Qendër, **qëndron** detyrimi ta paraqesin këtë dokument **brenda datës 15 Dhjetor 2021** dhe në çdo rast përpara fillimit të sezonit dimëror të provimeve.
- 4.3 Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Didaktike e Universitetit nga ku transferohet (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse). Dokumentacioni duhet të jetë në origjinal apo fotokopje e noterizuar, i pajisur me vulë Apostile. Vula Apostile kërkohet vetëm në rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj. **Dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin përfundimtar duhet të jetë i njëjtë me versionin elektronik të përdorur në regjistrimin për konkurs.**

¹ Informacionet se si mund të pajiseni me dokumentin e njehsimit të Diplomës universitare gjenden në faqen e internetit: <https://unizkm.al/>



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- 4.4 Mandatin e kryerjes së pagesës së kështit të parë apo të kështit të plotë të tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti, zëri "Tariffe");
- 4.5 Diplomën e shkollës së mesme origjinale dhe fotokopjen e noterizuar të saj;
- 4.6 Dokumenti i njehsimit² të Diplomës së shkollës së mesme lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë origjinal ose në kopje të noterizuar (vetëm për kandidatët që e kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit). Për ata që nuk janë pajisur me dokumentin e Njehsimit, **qëndron** detyrimi ta paraqesin këtë dokument **brenda datës 15 Dhjetor 2021** dhe në çdo rast përpara fillimit të sezonit dimëror të provimeve.
- 4.7 Dëftesat e të gjitha viteve të shkollës së mesme origjinale dhe fotokopjet e noterizuara të secilës;
- 4.8 Vërtetim banimi;
- 4.9 Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të ndjekur studimet;
- 4.10 Certifikatë familjare;
- 4.11 Dy foto format dokumenti.

Universiteti Katolik "ZKM" ka të drejtën të verifikojë vërtetësinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga kandidati me Institucionin e Arsimit të Lartë nga vjen, përpara se të regjistrojë studentin në programin përkatës.

Kandidatët të cilët do të kenë mangësi në dorëzimin e dokumentave të cituar në pikën 4.2 dhe 4.6 do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë. Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e Ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al/);
- Kontrata e regjistrimit.

Kreu II-Procedurat e pranimit në një program të dytë studimi për kandidatët e huaj.

1. Si të aplikoni për program të dytë studimi

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.6, datë 25/06/2021 të QSHA dhe RASH, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për regjistrim në një program të dytë studimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të Universitetit Katolik ZKM **nga data 2 Shtator deri në datën 13 Shtator 2021.**

Për të aplikuar për program të dytë studimi në Universitetin Katolik ZKM, kandidatët **duke nisur nga data 2 Shtator 2021** duhet:

- Të regjistrohen *online* në Portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>
 - Të për zgjedhin zërin: "**Secondo corso di laurea**"
 - Të plotësojnë procedurën duke ngarkuar online kopje elektronike në format PDF (të skanuara në format pdf/A) dokumentacionin e mëposhtëm për regjistrimin në një program të dytë studimi.
- a) Formulari i aplikimit për program të dytë studimi drejtuar IAL (shkarkohet në portalin: <http://admissions.unizkm.al/#/>)
 - b) Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve të mëparshme universitare, të shoqëruar me suplementin e diplomës;

² Informacionet se si mund të pajiseni me dokumentin e njehsimit të Diplomës së shkollës së mesme gjenden në faqen e internetit: <https://unizkm.al/>



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- c) Vërtetim të studimeve të kryera, të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet; (vetëm për kandidatët që kërkojnë njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);
- d) Diplomën e Shkollës së Mesme;
- e) Certifikatë e Diplomës së shkollës së mesme me të dhënat përkatëse (provimi me shkrim, provimi me gojë, kreditet, pikët shtesë), që përbëjnë vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore. Në mungesë të certifikatës, mund të bashkëlidhet një vërtetim i vulosur dhe nënshkruar nga shkolla e mesme me vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore dhe rezultatet e detajuara (provim me shkrim, provim me gojë, etj);
- f) Dëftesat e të gjitha viteve të Shkollës së Mesme;
- g) Kartë identiteti ose Pasaportë.
- h) Pagesën e tarifës prej 50 € për aplikim³ (pagesa kryhet me kartë krediti në të njëjtin portal: <http://admissions.unizkm.al/>).

Shënim: Nëse dokumentacioni i mësipërm nuk është në gjuhën italiane, duhet të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet përpara se të ngarkohet në Portalin e Universitetit.

Pas ngarkimit të dokumentacionit të mësipërm, do të kryhen verifikimet përkatëse për çdo kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>.

2. Procedurat e pranimit

2.1 Për programet e studimit në Infermieristikë, Fizioterapi, Mjekësi, Odontoiatri dhe Proteza Dentare:

Kandidatët që rezultojnë të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në Portalin <http://admissions.unizkm.al/>, duhet të kryejnë testimin e pranimit pranë Universitetit Katolik për kuotat e parashikuara për pranimet në programin e studimit në Fakultetin e Mjekësisë, në datat e mëposhtme:

- **Për kandidatët nga vendet e BE** testimet e pranimit do të kryhen në datat:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	29/09/2021	11:00
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	29/09/2021	11:00
Program i studimit në <i>Fizioterapi</i>	30/09/2021	11:00
Program i studimit në <i>Infermieristikë</i>	30/09/2021	11:00

Vlerësimi i kandidatëve nga vendet e BE do të bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara në testimin me shkrim dhe notës mesatare të shkollës së mesme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	60 pikë
2. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë

³Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

	Totali	90 pikë
--	---------------	----------------

Brenda datës 21 Shtator 2021, kandidatët nga vendet e BE-së që janë kualifikuar për program të dytë studimi dhe do të marrin pjesë në testimet e pranimit në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë duhet të **paguajnë tarifën prej 100 euro⁴ për pjesëmarrjen në testim** (pagesa kryhet me kartë krediti në të njëjtin portal: <http://admissionions.unizkm.al/>).

➤ **Për kandidatët nga vendet jo-BE** testimet e pranimit do të kryhen në datat:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	24/09/2021	11:00
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	24/09/2021	14:00
Program i studimit në <i>Fizioterapi</i>	24/09/2021	16:00
Program i studimit në <i>Infermieristikë</i>	24/09/2021	16:00

Vlerësimi i kandidatëve nga vendet jo-BE bëhet në bazë kritereve të mëposhtme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali	80 pikë

Brenda datës 21 shtator 2021, kandidatët nga vendet jo-BE që janë kualifikuar për program të dytë studimi dhe do të marrin pjesë në testimet e pranimit në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë do të duhet të **paguajnë tarifën prej 100 euro⁵ për pjesëmarrjen në testim** (pagesa kryhet me kartë krediti në të njëjtin portal: <http://admissionions.unizkm.al/>).

Testimet e pranimit do të zhvillohen në selinë e Universitetit Katolik "ZKM" në Rr. “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri. Nëse ka ndonjë ndryshim për shkak të emergjencës Covid-19, kandidatët do të informohen në kohë.

Një komision i veçantë didaktik do të vlerësojë karrierën universitare të kandidatëve të shpallur fitues të testimit të pranimit. Komisioni Didaktik bën njohjen/njehsimin e plotë apo të pjesshëm të krediteve ECTS/të provimeve të

⁴ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.

⁵ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

shlyera dhe përcakton vitin specifik ku do të regjistrohet kandidati, në qoftë se programi i studimit i përfunduar më parë është i të njëjtës fushë ose të një fushe të përafërt me programin e studimit ku ai aplikon. Në rast të kundërt, procedohet me regjistrimin e kandidatit në vit të Parë (I).

2.2 Në programet e studimit në Farmaci, Ekonomi Ndërmarrjeje:

Dokumentacioni i kandidatëve që aplikojnë për program të dytë studimi do t'i paraqitet Komisionit Didaktik ad hoc të secilit program për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara për çdo kandidat nga mesatarja e përgjithshme së shkollës së mesme dhe nga studimet universitare të kryera më parë:

1.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	50 pikë
2.	Studimet universitare të kryera më parë (kreditet e njohura)	50 pikë
	Totali	100 pikë

3. Listat e renditjes

Listat e renditjes së aplikantëve do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM <https://www.unizkm.al/>. Kandidatët mund të përjashtohen nga lista e renditjes nëse gjenden parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për aplikim.

4. Procesi i regjistrimit

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.6, datë 25/06/2021 të QSHA dhe RASH, kandidatët e shpallur fitues duhet të kryejnë regjistrimin përfundimtar nga data **7 deri më datë 11 Tetor 2021**, duke dorëzuar pranë Sekretarive Mësimore përkatëse dokumentacionin e mëposhtëm:

- 4.1 Kopje të noterizuar, të pajisur me vulën Apostile të vendit të origjinës të diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;
- 4.2 Dokumenti i njehsimit ⁶të Diplomës universitare së studimeve universitare të kryera më parë lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë origjinal ose në kopje të noterizuar (për kandidatët që e kanë kryer procedurën e njehsimit). Për ata që nuk janë pajisur me dokumentin e Njehsimit nga kjo Qendër, **qëndron** detyrimi ta paraqesin këtë dokument **brenda datës 15 Dhjetor 2021** dhe në çdo rast përpara fillimit të sezonit dimëror të provimeve;
- 4.3 Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Didaktike e Universitetit nga ku transferohet (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse). Dokumentacioni duhet të jetë në origjinal apo fotokopje e noterizuar, i pajisur me vulë Apostile. **Dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin përfundimtar duhet të jetë i njëjtë me versionin elektronik të përdorur në regjistrimin për konkurs,**
- 4.4 Mandatin e kryerjes së pagesës së tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali student, zëri "Tariffe");
- 4.5 Diplomën e shkollës së mesme (origjinale) dhe fotokopjen e noterizuar të saj;

⁶ Informacionet se si mund të pajiseni me dokumentin e njehsimit të Diplomës universitare gjenden në faqen e internetit: <https://unizkm.al/>



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- 4.6 Dokumenti i njehsimit⁷ të Diplomës së shkollës së mesme lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë origjinal ose në kopje të noterizuar. Për ata që nuk janë pajisur me dokumentin e Njehsimit, **qëndron detyrimi** ta paraqesin këtë dokument **brenda datës 15 Dhjetor 2021** dhe në çdo rast përpara fillimit të sezonit dimëror të provimeve.
- 4.7 Dëftesat e të gjitha viteve të shkollës së mesme origjinale dhe fotokopjet e noterizuara të secilës prej tyre;
- 4.8 Certifikatë e Diplomës së shkollës së mesme firmosur dhe vulosur nga gjimnazi/shkolla e mesme, me të dhënat përkatëse (provimi me shkrim, provimi me gojë, kreditet, pikët shtesë) që përbëjnë vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore në origjinal dhe *fotokopjen e noterizuar të saj*;
- 4.9 Vërtetim banimi;
- 4.10 Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (i nevojshëm për lejen e qëndrimit);
- 4.11 Certifikata penale (e nevojshme për lejen e qëndrimit);
- 4.12 Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të ndjekur studimet;
- 4.13 Dy foto format dokumenti.

Universiteti Katolik “ZKM” ka të drejtën të verifikojë vërtetësinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga kandidati me Institucionin e Arsimit të Lartë nga vjen, përpara se të regjistrojë studentin në programin përkatës.

Shënim: Ju kujtojmë se shtetasit e huaj mund të qëndrojnë lirisht në Shqipëri për një periudhë maksimale prej 90 ditësh në një gjashtëmujor (gjashtëmujori llogaritet nga dita e hyrjes së parë në vend dhe 90 ditët llogariten duke shtuar të gjitha periudhat e qëndrimit në Shqipëri, edhe nëse jo të njëpasnjëshme). Ata që synojnë të qëndrojnë në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë në një gjashtëmujor, duhet të paraqesin kërkesë për leje qëndrimi pranë autoriteteve kompetente shqiptare dhe duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore një kopje të noterizuar të lejes së qëndrimit në Shqipëri.

Kandidatët të cilët do të kenë mangësi në dorëzimin e dokumentave të cituar në pikën 4.2 dhe 4.6 do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë. Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e Ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al/);
- Kontrata e regjistrimit.

Rektori

Prof. Bruno Giardina



⁷ Informacionet se si mund të pajiseni me dokumentin e njehsimit të Diplomës së shkollës së mesme gjenden në faqen e internetit: <https://unizkm.al/>